



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

Tiranë, më . 03.2019

Lënda: Dërgim vendimi

QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT

TIRANE

Bashkëlidhur kësaj shkrese ju dërgojmë vendimin me Nr. 8106 datë 04.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane.

K/SEKRETARE

✓ Valbona SADIKU



-REP/
GYKAT
TIRA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

Nr: 10308 Regj. Themeltar
Dt. regjistrimi 07. 06. 2017

Nr: 8106 Vendimi
Dt. vendimi 04. 10. 2017



VENDIM
“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbërë nga :

Gjyqtar : ERVIN POLLOZHANI

asistuar nga sekretare gjyqesore **Lusjana Fezollari**, sot më datë **04. 10. 2017**, mori në shqyrtim në seancë gjyqesore publike, çështjes civile me Nr. **10308 Regj. Themeltar** që i përket :

PADITESA :

+ **SHOQERIA « DIETA » sh.p.k.**, me seli ne Elbasan, Shirgjan, Fshati Kuqan, me NIPT K82801220I, me perfaqesues ligjor z. Klajdi Shopi, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim perfaqesimi dt. 19. 06. 2017 nga *av. Alban Alimema*.

+ **SHOQERIA « RATI » sh.p.k.**, me seli ne Tirane, Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Komuna e Parisit, Pallati Rati, kati 1 perballe Universitetit New York, me NIPT K71911010Q, me perfaqesues ligjor z. Arif Alla, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim perfaqesimi dt. 19. 06. 2017 nga *av. Alban Alimema*.

TE PADITUR :

+ **ZYRA PERMBARIMORE “DEBIT COLLECTION”** me perbarues gjyqesor z. Tomorr Llalla, me adrese Rruga “Myslym Shyri”, Vila Nr. 8/1, kati 3 Tirane (*ne mungese*).

+ **SHOQERIA « MEGA WAT » sh.p.k.**, me seli ne Tirane, Njesia Bashkiake Nr. 5, Blloku 1 Maji, Rruga « Komuna Parisit » (615) Godina Nr. 10, Kati i pare, Hyrja 15, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim perfaqesimi dt. 21. 06. 2017 nga *av. Mujo Haxhiraj dhe z. Eduard Nallbani*.

+ **SHOQERIA « HYDRO ENERGJI TRANSFORMER TOPCIAS-EL » (W.E.T.T) sh.p.k.**, me seli ne Elbasan, Shirgjan, Fshati Topcias, me NIPT L03010201S, me perfaqesues ligjor z. Albert Shopi dhe z. Bujar Nurka (*ne mungese*).



OBJEKTI :

1. Marrja e masës së sigurimit duke pezulluar veprimet permbarimore të permbaruesit Tomor Llalla për ekzekutimin e Urdherit të Ekzekutimit Nr. 8195, datë 02.12.2015 për titullin ekzekutiv fature tatimore Nr. 37, Nr. Serie 86498237, dt. 01.08.2015, persa i perket sekuestros dhe shitjes së kuotave në pronesi të shoqërisë "Rati" sh.p.k dhe "Dieta" sh.p.k.
2. Përjashtimi nga sekuestro dhe shitja e kuotave të kapitalit të shoqërisë "Hydro Energji Transformer Topcias – El" (W.E.T.T.) sh.p.k që zotërohen nga "Rati" sh.p.k dhe "Dieta" sh.p.k
3. Kundershtimi dhe anulimi i veprimeve të permbaruesit Tomor Llalla për ekzekutimin e Urdherit të Ekzekutimit Nr. 8195, datë 02.12.2015 për titullin ekzekutiv, fature tatimore Nr. 37, Nr. Serie 86498237, dt. 01. 08. 2015, persa i perket sekuestros dhe shitjes së kuotave në pronesi të shoqërisë "Rati" sh.p.k. dhe "Dieta" sh.p.k.
4. Fshirjen në Qendren Kombëtare të Biznesit të urdherit Nr. 1782 Prot, datë 27. 07. 2016 "Për vendosjen e sekuestros konservative".

BAZA LIGJORE :

Neni 32, 154, 610, 612 dhe 615/a të K. Pr. Civile.

Gjykata, pasi administroi provat shkresore, degjoi pretendimet perfundimtare të perfaqësuesit të paditesave, i cili kërkoi: *Pranimin e kerkese-padise sipas objektit të saj*, pretendimet perfundimtare të perfaqësuesit të të paditurit, shoqëria "Mega Wat" sh.p.k., i cili kërkoi: *Rrezimin e kerkese-padise si të pazuar në ligj dhe në prova*, pasi e shqyrtoi çështjen në teresi në mungesë të të paditurve të tjerë, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor,

VEREN:

Se, pala paditese shoqëritë « Dieta » sh.p.k. dhe « Rati » sh.p.k. nepermjet perfaqësuesit të tyre i janë drejtuar kësaj gjykate, me kërkesë-padine me objektin e sipërpermendur. Gjithashtu, pala paditese për efekt të kerkimit të kerkese-padise ka kërkuar të pezullohen kryerjet e veprimeve të metejshme të permbaruesit gjyqësor për shitjen e kuotave të shoqërisë « Hydro Energji Transformer Topcias-El » sh.p.k. në pronesi të ortakeve të kësaj shoqërie konkretisht paditesave « Rati » sh.p.k. dhe « Dieta » sh.p.k., deri në shqyrtimin gjyqësor të kësaj çështjeje. Lidhur me këtë kerkim gjykata me vendimin e sa dt. 23. 06. 2017 ka vendosur : *Pranimin e kerkeses. Marrjen e masës së perkohshme për pezullimin e veprimeve permbarimore të permbaruesit gjyqësor privat Tomor Llalla për ekzekutimin e Urdherit të Ekzekutimit Nr. 8195 Akti dt. 02. 12. 2015 të Gjykates së Rrethit Gjyqësor Tirane për titullin ekzekutiv, Fature Tatimore Shitjeje Nr. 37 dt. 01. 08. 2015, Nr. 86498237 Serie, vetem persa i perket sekuestros dhe shitjes së kuotave të shoqërisë "Hydro Energji Transformer Topcias-El" (W.E.T.T.) sh.p.k. deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes.*

Përpara shqyrtimit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë në prova të kërkesë-padisë, gjykata konstatoi se në bazë të Neneve 35, 36/1, 42/1, 45, 50, 59, 612 të Kodit të Procedurës Civile, çështja objekt gjykimi hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore dhe tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pala paditese, bazuar në Nenin 32/a të K. Pr. Civile legjitimohet t'i drejtohet gjykates me këtë kerkese-padi në bazë të se ciles do të përfitojë të drejta personale - pasurore.

Gjithashtu gjykata, në vështirim të neneve 71, 72 dhe 73 të K. Pr. Civile, çmoi se nuk ekzistojnë për të, shkaqe papajtueshmërie, ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pa kundërshtuar dhe nga palet prezent në gjykim.

Në bazë të nenit 35 të K. Pr. Civile gjykimi u zhvillua nga një gjyqtar.

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi e provuar se :

Shoqerite "Rati" sh.p.k dhe "Dieta" sh.p.k, jane ortake secila me 50 % te pjesemarrjes se tyre ne kapitalin e shoqerise "Hydro Energji Transformer Topcias - El" (W.E.T.T.) sh.p.k, shoqeri koncesionare e themeluar nga shoqerite "Rati" sh.p.k dhe "Dieta" sh.p.k me objekt: *"Financim, projektim, ndertimi, venie ne pune, administrimi, mirëmbajtje, prodhim dhe tregtim te energjise, te hidrocentralit "TOPCIAS" dhe transferim ne baze te lejeve te koncesionit te formes BOT te dhene nga Ministria e Ekonomise, Tregetise dhe Energjitikes dhe autorizuar nga Keshilli i Ministrave, per shfrytezimin e ujit te lumit Shkumbin per prodhimin e energjise elektrike"*.

Kjo shoqeri per shkak te objektit te saj te veprimtarise ka lidhur me Ministrine e Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes (sot Ministria e Energjitikes dhe e Infrastruktures) Kontraten e Koncesionit te formes BOT Nr. 2393 Rep. Nr. 1219 Kol. dt. 24. 05. 2010 me bashkimin e perkohshem te shoqerive « Dieta » sh.p.k. dhe « Rati » sh.p.k. per ndertimin e HEC-it TOPCIAS.

Ne zbatim te kontrates se koncesionit keto shoqeri (paditesat) kane krijuar dhe regjistruar prane QKB-se shoqerine koncesionare « Hydro Energji Transformer Topcias-El » sh.p.k.

Per qellime te kontrates kjo shoqeri ka hyre ne nje marredhenie kontraktore me palen e paditur shoqerine « Mega Wat » sh.p.k. qellimi i se ciles ka qene projektimi dhe zbatimi i plote per H/C Topcias. Per kete marredhenie eshte leshuar dhe fatura tatimore respektive Nr. 7 dt. 01. 08. 2015 ne vleren 7. 100. 000 lek.

Ne kushtet kur kjo vlere e detyrimit qe permban fatura e siperpermendur nuk eshte likujduar vullnetarisht nga pala debitore shoqeria « Hydro Energji Transformer Topcias-El » sh.p.k., pala kreditore shoqeria « Mega Wat » sh.p.k. i eshte drejtuar gjykates per leshimin e urdherit te ekzekutimit per kete fature tatimore, titull ekzekutiv. Gjykata nga ana e saj pasi e ka shqyrtuar kerkesen, me vendimin e saj Nr. 8195 Akti, date 02. 12. 2015 ka leshuar urdherin e ekzekutimit per faturen tatimore me Tvsh Nr. 37, Nr. Serie 86498237, date 01. 08. 2015, ne shumen 7. 100. 000 lek, leshuar nga shoqeria "MegaWat" sh.p.k. per shoqerine « Hydro Energji Transformer Topcias - El" sh.p.k.

Mbas marrjes se titullit ekzekutiv, kreditori shoqeria « MegaWat » sh.p.k., konform kerkesave proceduriale ligjore te parashikuara ne Nenet 515 e vijues te K. Pr. Civile me kerkesen dt. 15. 06. 2015 ka vene ne levizje shoqerine permbarimore « Debit Collection » sh.p.k. per te vene ne ekzekutim kete titull ekzekutiv. Nga ana e saj shoqeria permbarimore sipas shpjegimeve te dhena ne kete proces, te perfaqesuesit te pales paditese si dhe te asaj pjese te praktikës permbarimore perkatese te paraqitur ne seance, e ka vene ne levizje kete kerkese duke i derguar debitorit, me shkresen Nr. 415 Prot, Nr. 306 Regj, date 16. 01. 2016 "Lajmerim per ekzekutim vullnetar" e cila eshte marre me dt. 18. 01. 2016. Pas njoftimit te lajmerimit per ekzekutim vullnetar nga ana e permbaruesit, sipas pales paditese, asaj nuk i eshte njoftuar me asnje veprim tjeter permbarimor.

Me vone ka rezultuar se me date 03. 06. 2017, pales paditese i eshte njoftuar shkresa Nr. 538 Prot, date 02. 05. 2017 e permbaruesit gjyqesor privat Tomor Llalla, "Njoftim mbi aktin e vleresimit date 10. 05. 2017" dhe bashkengjitur saj dhe dokumenti "Raporti i vleresimit te pasurive te luajshme ne pronesi, titujt e pronesise se shoqerise "Hydro Energji Transformer Topcias - El" sh.p.k.



Megjithese nga permbajtja e shkreses dhe raportit te vleresimit nuk del e qarte perse behet fjale, sipas pales paditese kuptohet qe permbaruesi ka nisur procedurat per shitjen e sendeve te luajtshme te sekuestruara dhe te vetmet sende te luajtshme mbi te cilat ai ka vendosur sekuestro jane kuotat e kapitalit te shoqerise "Hydro Energji Transformer Topcias - El" sh.p.k" te cilat zoterohen nga shoqerite "Rati" sh.p.k. dhe "Dieta" sh. p. k.

Ne keto kushte, ne perputhje me nenin 612 (pacia per kerkimin e sendit nga personi i trete) dhe 610 (pacia per kundeshkrimin e veprimeve permbarimore) te Kodit te Procedures Civile pala paditese i eshte drejtuar gjykates me kete kerkese-padi duke kerkuar perjashtimin nga sekuestro dhe shitja e metejshme e kuotave te kapitalit te shoqerise "Hydro Energji Transformer Topcias - El" sh.p.k. te cilat zoterohen nga shoqerite "Rati" sh.p.k. dhe "Dieta" sh.p.k.

Sipas pretendimeve te pales paditese, ndryshe nga sa thuhet ne shkresen e permbaruesit gjyqesor, kuotat mbi te cilat eshte vene sekuestro nuk jane tituj pronesie te shoqerise "Hydro Energji Transformer Topcias - El sh.p.k" (W.E.T.T.) por tituj pronesie te shoqerise "Rati" sh. p. k. dhe "Dieta" sh. p. k., qe ato zoterojne ne kapitalin e kesaj shoqerie si ortake te saj.

Shoqeria debitore "Hydro Energji Transformer Topcias – El » sh.p.k, eshte shoqeri tregtare e formes me pergjegjesi te kufizuar. Vete emertimi i kesaj forme shoqerie, shpreh thelbin e saj si nje shoqeri me risk te kufizuar te ortakeve te saj. Ligji Nr. 9901 date 14. 04. 2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare » ne nenin 68 pika 1 te tij jep perkufizimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, konkretisht : « *Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar (shpk), eshte nje shoqeri tregtare, e themeluar nga persona fizike ose juridike, te cilet nuk pergjigjen per detyrimet e shoqerise tregtare ...* ».

Ne shoqerite me pergjegjesi te kufizuar, kapitali i shoqerise perfaqesohet nga kuotat, te cilat ne vetvete, perbejne te drejtat e ortakeve mbi kapitalin themeltar te shoqerise. Masa e pjesemarrjes se ortakeve ne kapitalin themeltar te nje shpk-je, pra perqindja e kuotave zoteruese, tregon sasine e te drejtave te tyre ne shoqeri, si per shembull: - te drejtat e votes ne asamble, - pjesen e ndarjes se fitimeve, - pjesen ne rezervat e shoqerise, - pjesen ne tepricen e likuidimit, etj.

Ne kete kuptim, *kuota e nje ortaku te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, eshte prone (e drejte) personale e tij dhe si e tille mund te sherbeje per permbushjen e detyrimeve personale te ortakut ndaj te treteve.* Nisur nga percaktimi i nenit 68.1 i sipercituar, keto kuota kurrsesi nuk mund te sherbejne per permbushjen e detyrimeve te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ndaj te treteve.

Rrjedhimisht, shoqeria debitore per kete detyrim pergjigjet personalisht me pasurine e saj. Duke qene nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ortaketi e kesaj shoqerie nuk mund te pergjigjen me pasurite e tyre per detyrimet e saj.

Sipas pales paditese, shoqeria "Hydro Energji Transformer Topcias - El sh.p.k, (W.E.T.T.) », eshte nje shoqeri koncesionare dhe eshte akoma ne fazen e marrjes se lejeve te nevojshme dhe sigurimit te financimit per ndertimin e HEC-it Topcias dhe ne keto kushte ajo akoma nuk ka filluar aktivitetin e saj dhe nuk gjeneron te ardhura. Kjo eshte arsyeja pse ajo nuk ka pasuri per shlyerjen e detyrimit ndaj shoqerise "MegaWat" sh.p.k.

Ne keto kushte, veprimet e permbaruesit gjyqesor per ekzekutimin e titullit ekzekutiv edhe ndaj pasurise se ortakeve te shoqerise debitore, jane te paligjshme.

Gjithashtu, sipas pales paditese eshte e rendesishme te theksohet se shoqeria "Hydro Energji Transformer Topcias - El sh.p.k, (W.E.T.T.) duke qene nje shoqeri koncesionare e themeluar sipas detyrimeve te kontrates se koncesionit te lidhur me Ministrine e Energjise dhe Industrise, kuotat qe shoqerite "Rati" sh.p.k dhe "Dieta" sh.p.k. zoterojne aty mund te transferohen vetem me miratimin paraprak te

Ministrise. Nje fakt i tille evidentohet edhe nga shkresa Nr. 4361/1 Prot. dt. 08. 06. 2017 e Ministrise se Energjise dhe Industrise. Rrjedhimisht, edhe per kete arsye veprimet e permbaruesit jane te paligjshme.

Per te gjitha keto shkaqe ligjore pala paditese, i eshte drejtuar gjykates me kete kerkese-padi me ndergjyqesine, objektin dhe shkakun ligjor te siperpermendur.

Lidhur me pretendimin e pales se paditur, se jemi para gjese se gjykuar, pala paditese prapsoi se ky pretendim nuk provohet se ekziston si i tille. Kjo pasi nuk plotesohet asnje kriter i percaktuar ne nenin 451/a te K. Pr. Civile. Ne analize te kesaj dispozite, rezulton se elementet e gjese se gjykuar jane: (i) Te njehatat pale (identiteti i paleve); (ii) I njehati objekt (identiteti i objektit); (iii) I njehati shkak (identiteti i shkakut). Duke analizuar pala paditese si ne shpjegimet gjate procesit gjyqesor, ashtu dhe ne konkluzionet perfundimtare, te gjitha proceset gjyqesore te meparshme te zhvilluara si te tilla pare midis ketyre paleve ndergjyqese, ne raport me nenin 451/a te K. Pr. Civile, provohet plotesisht se nuk jemi perpara ketij parimi procedural, *res judicata*.

Nga ana e tyre perfaqesuesit e shoqerise « MegaWat » sh.p.k. shprehen se teresia e veprimeve te kryera nga ana e permbaruesit gjyqesor ka qene ne perputhje me ligjin procedural civil per ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Keshtu sipas tyre referuar praktikës se paraqitur permbarimore jane kryer me rigorozitet te gjitha veprimet permbarimore ne afatet dhe menytrat e percaktuara ne ligj. Sipas tyre pala paditese nepermjet kesaj padie kerkon qe te shmange pergjegjesine e saj ligjore per te shlyer detyrimin qe buron nga fatura tatimore titull ekzekutiv e cila si e tille eshte ligjeruar nga gjykata qofte me vendimin e leshimit te urdherit te ekzekutimit ashtu dhe me procese te tjera gjyqesore te cilat kane rrezuar pretendimet e pales paditese per pavlefshmerine e saj.

Krahas kesaj sipas kesaj pale kjo ceshtje gjyqesore nuk eshte ne kompetencen tokesore te kesaj gjykate pasi qe selia e pales se paditur-debitore "Hydro Energji Transformer Topcias - El sh.p.k, (W.E.T.T.) sh.p.k. eshte ne qytetin e Elbasanit dhe kompetente duhet te ishte kjo gjykate nga pikepamja e kompetence tokesore per shqyrtimin e metejshe me te saj.

Gjithashtu kjo pale shprehu edhe se kjo ceshtje gjyqesore perben gje te gjykuar pasi qe objekti i saj eshte zgjidhur me vendimin gjyqesor te formes se prere, Nr. 334 dt. 03. 05. 2017 te Gjykates se Apelit Tirane.

Gjykimi per te paditurit e tjere u zhvillua ne mungese te tyre, pasi qe ndonese merrnin dijeni nuk u paraqiten ne gjykim ne asnje seance gjyqesore duke vleresuar ne kete menyre gjykata qendrimin e kesaj pale ne harmoni me shpjegimet e paleve te tjera ndergjyqese si dhe me provat e administruara ne gjykim.

Nga ana e saj gjykata referuar objektit dhe baze ligjore te kerkese-padise si dhe perpos shpjegimeve te paleve ndergjyqese çmon se referuar Nenit 6 te K. Pr. Civile percaktohet se: "Gjykata qe gjykon mosmarrëveshjen duhet te shprehet mbi gjithçka qe kërkohe dhe vetëm për atë qe kërkohe". Nga ana tjetër Neni 16/1 përcakton se "Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore..... Gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës. Në Nenin 28 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: "Gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrohen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm". Në kuptim të këtyre dispozitave gjykata në ushtrimin e veprimtarisë së saj, udhëhiqet gjithnjë nga ligji, nuk e paragjykon çështjen objekt gjykimi dhe u krijon palëve të gjitha hapësirat ligjore për të realizuar një proces të drejtë gjyqësor. Cilësimi juridik i fakteve bëhet në përputhje me cilësimin ligjorë të tyre. Në këtë kuptim gjykata referuar Nenit 17 te K. Pr. Civile ka orientuar palet ndergjyqese duke i ftuar ato te japin shpjegime



nga pikepamja e se drejtes qe ato e çmojne te nevojshme per zgjidhjen e mosmarreveshjes.

Padia "Kundërshtimi i veprimeve të përmbaruesit gjyqësor", është një mjet në duart e palëve, i cili ka për qëllim të kundërshtojë veprimet (aktet procedurale) që kryhen nga përmbaruesi gjatë procesit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, ose kundër refuzimit të përmbaruesit për të ekzekutuar një titull ekzekutiv. Në këto lloj gjykimesh gjykata vetëm vlerëson nëse veprimet e përmbaruesit gjyqësor janë kryer në përputhje me ligjin apo jo. Kjo padi referencen e saj e ben per fazen e ekzekutimit te vendimeve gjyqesore si titull ekzekutiv. Ajo lidhet drejtpërdrejt me veprimet apo mosveprimet e përmbaruesit gjyqësor dhe si e tille gjykata shqyrtimin e kesaj padie e ben vetem per keto veprime apo mosveprime te përmbaruesit gjyqësor. Ne kete menyre çmuarja e themelsise se kesaj padie nga pikepamja e se drejtes lidhet vetem me keto veprime te përmbaruesit gjyqësor dhe jo me themelin e çështjes i cili eshte zgjidhur si i tille me leshimin e urdherit te ekzekutimit. Çdo veprim procedural i përmbaruesit gjyqësor perben objekt ankimi gjyqësor dhe ky fakt eshte nje garanci ligjore per mbrojtjen e interesave te paleve ne çdo faze te ekzekutimit. Kontrolli gjyqësor i veprimeve te përmbaruesit gjyqësor lidhet me garancite procedurale te barazise se armeve te paleve ndergjyqese garanci keto qe gjejne zbatim edhe gjate procesit te ekzekutimit te nje titulli ekzekutiv.

Perpos ketyre parimeve, ne rastin objekt shqyrtimi nderthurja e kesaj padie me themelin e pretendimit te pales paditese lidhet me faktin se te drejtat e saj reale prevalojne si te tilla pavarësisht fazes se ndodhjes se veprimeve permbarimore.

E drejta e mbrojtjes, me mjetin procedural te kerkese-padise se posaçme, seciles pale qe preket drejtpërdrejt apo dhe ne menyre indirekte me veprimet e nje pale tjeter qofte dhe ate te nje subjekti te posaçem si përmbaruesit gjyqësor, parimisht nuk mund t'i cenohet asaj ne çdo faze qe ndodhet procesi i ekzekutimit te detyrimit.

Sa me siper, te drejten e saj kjo pale ne referim te parimeve te pergjithshme mbi konceptin e padise e ka mbështetur ne nenet 31, 32/a dhe 612 e vijues te K. Pr. Civile. Sipas tyre « Padia eshte e drejta e personit qe ben pretendimin per t'u degjuar mbi themelin e ketij pretendimi ne menyre qe gjykata ta shpalle ate te bazuar ose jo ».

« Padia mund te ngrihet per te kerkuar rivendosjine e nje te drejte ose interesi te ligjshem qe eshte shkelur ».

Po keshtu referuar rregullimeve te posaçme per te drejten e padise se personit te trete qe pretendon te drejta pronesia mbi sendin objekt sekuestroje, ne Nenin 612 i K. Pr. Civile percaktohet se: "Çdo person i tretë që pretendon se është pronar i sendit mbi të cilin bëhet ekzekutimi, mund të ngrejë padi për të ushtruar të drejtën e tij dhe kur është rasti për të përjashtuar sendin nga sekuestrimi dhe shitja. Padia ngrihet kundër kreditorit dhe debitorit në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit. Në këto raste, gjykata mund të vendosë si masë të përkohshme pezullimin e ekzekutimit me ose pa garanci".

Perpos kesaj, referuar parimeve procedurale te siperpermendura, pare ne harmoni dhe me konkluzionet e vendimit unifikues te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte Nr. 3 dt. 29. 03. 2012 lidhur me bazen ligjore te kerkese-padise gjykata nisur nga parimi *iuria novit curia* (gjykata e njej ligjin) çmon se ne rastin konkret shkaku ligjor i kerkese-padise eshte i qarte dhe i kuptueshem ne lidhje me objektin e kerkimit te pretenduar. Sipas ketij vendimi eshte unifikuar se: *gjykata e zbulon shkaku e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj. Mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kërkesë-padisë del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojë. Në këtë rast gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkaku që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesë-padisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i*

janë cenuar.

Ne kete menyre kendveshtrimi i gjykates lidhur me kete çeshtje objekt konflikti lidhet pikerisht me cilesine e te qenuarit pronar ose jo te pales paditese mbi pasurine objekt ekzekutimi.

Sa me siper ne lidhje me themelin e kerkimeve, gjykata pasi degjoi palet ndergjyqese dhe shqyrtoi provat shkresore, çmon se, parimisht askujt nuk mund t'i cënohet e drejta e pronësise përveç rasteve te parashikuara ne Kushtetute dhe ligje. Askush nuk mund te perdore autoritetin e tij për t'i marre arbitrarisht pronën subjekteve legjitime jashtë qëllimit dhe parashikimeve të ligjit. Për këto raste, një ndër instrumentat ligjorë të mbrojtjes së interesave pasurore të subjekteve që preken në pronësi në mënyrë të padrejtë gjatë procesit të ekzekutimit të një titulli ekzekutiv pa qenë palë, është padia e "*Kërkimi i sendit nga personi i tretë*" mbështetur ne nenin 612 te K. Pr. Civile. Nëpërmjet saj, paditësi duke provuar qënien pronar mbi sendet objekt ekzekutimi dhe mosqënien palë në titullin ekzekutiv, kërkon të ndreqë gabimet e përmbaruesit gjyqësor gjatë fazës së ekzekutimit, të detyrueshëm dhe shmangien e pasojave të rënda që i vijnë nga ekzekutimi mbi një pronë të tjetrit.

Padia, pavaresisht natyres se saj procedurale per shkak se mbështetet ne Kodin e Proçedurës Civile, në thelb ka natyrë reale pronësie (rivendikimi) në të njëjtën kohë dhe natyrë detyruese (personale). Paditësi duke provuar se është pronar i sendeve objekt ekzekutimi, pra se keto sende nuk i perkasin ne pronesi pales debitore ne proces ekzekutimi, kërkon dhe përjashtimin e tyre nga sekuestro dhe shitja në ankand. Njëkohësisht, për shkak të rrezikshmërisë dhe shpejtësisë së kryerjes se veprimeve lidhur me procedurat e shitjes se sendeve ne ankand dhe pasojat qe vijne prej tij, kërkohet dhe marrja e masës pezulluese deri në përfundimin e gjykimit të çështjes.

Në lidhje me sa u parashtua më sipër, për zgjidhjen e drejtë të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, gjykata çmon se është e nevojshme të zgjidhen çështjet juridike si vijon:

- 1) *A jane pale, paditesit, shoqerite "Dieta" sh.p.k. dhe "Rati" sh.p.k. në titullin ekzekutiv, faturen tatimore me Tvsh Nr. 37, Nr. Serie 86498237, date 01. 08. 2015, mbi bazen e se ciles po kryhen veprimet permbarimore dhe a rezultojne ato debitore në marrëdhënie me palen tjeter te paditur "Mega Wat" sh.p.k. ?*
- 2) *A njehsohen pasuritë personale të ortakëve me pasurinë e vetë shoqërisë dhe a mund të përgjigjet me pasurinë e tyre personale ortakët per detyrimet qe ka shoqëria ?*
- 3) *A jemi perpara parimit te gjese se gjykuar apo jo, ne aspektin material, në kuptim kjo të përcaktimeve të nenit 451/a të K. Pr. Civile ?*

Së pari: Rezultoi e provuar ne gjykim se procedurat e ekzekutimit nga permbaruesi gjyqesor po kryhen mbi bazen e nje titulli ekzekutiv, faturen tatimore me Tvsh Nr. 37, Nr. Serie 86498237 qe eshte leshuar nga shoqeria "Mega Wat" sh.p.k. perkundrejt shoqerise "Hydro Energji Transformer Topcias - El, (W.E.T.T.) sh.p.k.

Për të garantuar pagimin e kesaj shume detyrimi permbaruesi gjyqesor ka vene ne ekzekutim nepermjet vendosjes se sekuestros konservative, titujt e pronesise se ortakëve te kesaj shoqerie, konkretisht shoqerise "Dieta" sh.p.k. dhe "Rati" sh.p.k. konkretisht "kuotat e tyre" ne kete shoqeri koncensionare. Siç shihet, rezulton katerciperisht e provuar se shoqerite ortake ne shoqerine e detyruar nuk jane as pale ne titullin ekzekutiv, faturen tatimore me Tvsh Nr. 37, Nr. Serie 86498237 dhe as debitore ne kete marrëdhënie me shoqerine "MegaWat" sh.p.k. (kreditorin). Por, permbaruesi gjyqesor duke mos vlerësuar drejt kete fakt,



me Urdherin Nr. 1782 Prot. dt. 27. 07. 2016 te permbaruesit gjyqesor Tomorr Llala "Per vendosjen e mases se sekuestros konservative mbi titujt e pronesise ne pronesi te debitorit" shoqerise "Hydro Energji Transformer Topcias-El" (W.E.T.T.) sh.p.k."-te marre gjate gjykimit te ceshtjen, ne kundeshtim me ligjin i konsideron keto shoqeri si debitore ne keto marrredhenie.

Se dyti: Konceptin juridik te një shoqërie tregtare te kapitalit me përgjegjësi të kufizuar, siç është dhe paditësi në rastin konkret, e jep neni 68 i ligjit Nr. 9901 dt. 14. 04. 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ku sipas të cilit: "Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është një shoqëri tregtare e themeluar nga persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar"

Sipas këtij rregulli, shoqëria tregtare e llojit sh.p.k., është një ~~marrredhënie kontraktore~~ *marrredhënie kontraktore e posaçme me natyrë tregtare*, që mbi bazën e kapitalit apo me shërbime të palëve pjesmarrëse, krijon kushte për themelimin e një subjekti të ri, i aftë për të hyrë në qarkullimin juridiko-civil me personalitet dhe identitet të regjistruar. Me fitimin e personalitetit juridik, ai bëhet njëkohësisht dhe titullar i pasurisë së regjistruar nga ortakët si kapital themeltar i krijimit. Ashtu si dhe personat, shoqëria veç kapitalit mundet të jetë titullare e të drejtave pasurore në të gjithë format e tyre, ose subjekt aktiv apo pasiv i të drejtave reale e personale. Pra, ky subjekt i pavarur nga çdo subjekt duke përfshirë dhe krijuesit e saj ortakët, mund të disponojë pasuri krejt të vetën, e cila kurrësi nuk konfondohet me pasurinë e të tretëve dhe të ortakëve te saj.

Aksionarët dhe ortakët nuk janë as pronarë dhe as bashkëpronarë të pasurive të shoqërisë. Pronar i pasurisë së shoqërisë së fituar në përputhje me ligjin nga të tretët (përfshirë edhe ortakët) është vetëm shoqëria. Shoqëria tregtare gjatë veprimtarisë krijon, fiton, tjetëron, kalon apo transferon pasuri, gjithnjë në emër e për llogari të saj. Kapitali themeltar i shoqërisë nuk duhet konfunduar me pasurinë e shoqërisë. Kështu, krahas kapitalit themeltar shoqëria krijon pasuri të veten që përfshin të gjitha të drejtat dhe detyrimet e saj si, aktivet, pasivet, asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, mjete pune, qarkulluese, xhiroje ..., etj. Pronarë e ketyre të fundit është vetëm shoqëria, ndersa *ortakët nuk janë pronarë të sendeve të shoqërisë dhe nuk kanë asnjë të drejtë mbi aktivet e saj* (shih vendimin Nr. 100, datë 13. 03. 2014 te Kolegjit Civil te Gjykatës Larte). Madje edhe ortakëria apo pjesëmarrja në kuotat e një shoqërie tregtare nuk nënkupton se ortakët është bashkëpronar i shoqërisë. Kuotat janë në thelb një e drejtë pasurore e atij që i ka derdhur kontributet, të cilat përfaqësojnë dy cilësi; janëtribute të pagueshme në të holla (të drejtën për të marrë pjesë në fitime, në tepicën e likuiditetit etj.), ashtu dhetribute pjesëmarrje të ortakut në jetën e shoqërisë (e drejta e votës në asamble, e informimit, e kontrollit mbi administrimin etj.)

Pra, kuota nuk përbën në vetvete pasuri të mirëfilltë, por përfaqëson pjesën, raportin e të drejtës mbi të tërën në pasurinë e shoqërisë, e drejtë kjo që është në përpjestim me kontributin e titullarit të kuotës në kapitalin e shoqërisë. Pra, kapitali i një shoqërie ndahet në kuota të cilat në vetevete janë të drejta mbi të (kapitalin), asetet dhe mbi aktivitetin e shoqërisë. Në këtë kontekst termi "kuotë" përfaqëson një marrëveshje ligjore për të përkufizuar të drejtën.

Nga ana e tij permbaruesi gjyqesor duke mos patur te qarte konceptet e mesiperme ligjore, si dhe duke konfunduar dukshem statusin dhe personalitetin e personit juridik, ka proceduar me vleresimin per gellim te shitjes ne ankand te kuotave te shoqerise si te vetmet asetet monetare dhe materiale te saj. Konkretisht, me shkresen 538 Prot. dt. 02. 05. 2017 "Njoftim per aktin e vleresimit dt. 10. 05. 2017", bashkangjitur akti i ekspertimit rezulton se jane vleresuar te gjitha te drejtat dhe detyrimet e shoqerise si (aktivet dhe pasivet e shoqerise, aktiviteti financiar, pasuria, te ardhurat dhe detyrimet e shoqerise, mjetet materiale, monetare, asetet e luajtshme dhe paluajtshme.etj). Ne perfundim, eksperti ka percaktuar se totali i

gjendjes se asetëve materiale dhe monetare te shoqerise (titujve te pronesise-pasuri e luajtshme e saj) eshte 12, 160, 447 leke. Pra siç shihet, permbaruesi ka vleresuar dhe po shet ne ankand pasurine ekskluzive te ortakeve te shoqerise per te shlyer nje detyrim te marre nga vet shoqeria si subjekt debitorë ekskluziv.

Gjithashtu, eshte e rendesishme te theksohet se shoqeria "Hydro Energji Transformer Topcias - El sh.p.k, (W.E.T.T.) duke qene nje shoqeri koncesionare e themeluar sipas detyrimeve te kontrates se koncesionit te lidhur me Ministrine e Energjise dhe Industrise, kuotat qe shoqerite "Rati" sh.p.k dhe "Dieta" sh.p.k. zoterojne aty mund te transferohen vetem me miratimin paraprak te Ministrise. Nje fakt i tille evidentohet edhe nga shkresa Nr. 4361/1 Prot. dt. 08. 06. 2017 e Ministrise se Energjise dhe Industrise. Rrjedhimisht, edhe per kete arsye veprimet e permbaruesit jane te paligjshme.

Sa me siper u analizua, gjykata vlereson se pretendimi i pales paditese per perjashtimin nga sekuestrimi dhe shitja e kuotave te shoqerise "Hydro Energji Transformer Topcias-El" sh.p.k. dhe asetëve te saj materiale e monetare eshte plotesisht i ligjshem, i mbështetur ne fakte dhe prova.

Si derivat i kesaj vendimmarrje per kete pike te objektit te kerkese-padise per gjykatën dhe kerkimi i pikes se trete te objektit te kerkese-padise duhet te pranohet duke u anuluar veprimet e permbaruesit gjyqësor vetem persa i perket sekuestros dhe shitjes se kuotave te shoqerise "Hydro Energji Transformer Topcias-El" (W.E.T.T.) sh.p.k. dhe qe zoterohen nga shoqerite "Rati" sh.p.k. dhe "Dieta" sh.p.k. duke u fshire ne kete menyre edhe regjistrimi i bere ne QKB sipas urdherit Nr. 1782 Prot. dt. 27. 07. 2016 "Per vendosjen e mases se sekuestros".

Lidhur me pretendimit tjeter te pales se paditur/personit te trete, per faktin se ne kete gjykim jemi perpara parimit te gjese se gjykuar (*res judicata*) gjykata vlereson se nje pretendim i tille nuk provohet ligjerisht se qendron.

Në nenin 451/a të K. Pr. Civile parashikohet shprehimisht se : "*Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera.*


Vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për ç'ka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohej përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe".

Në analizë të kesaj dispozite, rezulton se elementet e gjësë së gjykuar qe te ekzistojne ne menyre kumulative duhet te jenë: (i) Të njëjtat palë (identiteti i palëve); (ii) I njëjti objekt (identiteti i objektit); (iii) I njëjti shkak (identiteti i shkakut). Ne lidhje me shkakun e padisë, ky i fundit është arsyeja e kërimit gjyqësor që përbëhet nga e drejta dhe nga një gjendje fakti që i kundërvihet kësaj të drejte. Që padia të merret në shqyrtim nga gjykata duhet të përmbajë në vetvete, jo vetëm kërkimin që përbën objektin e saj, por dhe shkakun. Është pikërisht shkakun i padisë, e drejta dhe gjendja e faktit që i kundërvihet kësaj të drejte, që përbën cenim të së drejtës së një subjekti/pale dhe që e motivon atë të verë në lëvizje gjykatën (neni 32 i K. Pr. Civile). Arsyeja e kërimit, mbi të cilën bazohet padia, përbëhet nga e drejta materiale ku ajo themelohet, pra është e drejta materiale e afirmuar në bazë të së cilës përcaktohet objekti (*petitum*) dhe gjendja e faktit që i kundërvihet kësaj të drejte.

Referuar përmbajtjes së dispozitës së sipërcituar rezulton se *gjëja e gjykuar në procesin civil shfaqet në 2 (dy) aspekte, në atë formale dhe në atë substanciale (materiale).*

a) *Në kuptimin formal* ajo shfaqet s'i një gjendje juridike e ezaurimit të mjeteve procedurale të ankimit, s'i dhe e ekzistencës së prekluzivitetit lidhur me mundësinë për t'u ankuar ndaj vendimit gjyqësor të formës së prerë.

b) *Në kuptimin substancial (material)* ajo kuptohet s'i një gjendje juridike jo thjesht pamundësie nga



palët ndërgjyqëse të vendimit gjyqësor të formës së prerë, për të rihapur shqyrtimin e çështjes, por edhe si një e drejtë e secilës prej tyre për të kundërshtuar mundësinë e rishikimit të zgjidhjes së dhënë për konfliktin në një gjykim të ri.

Në interpretim dhe zbatim të nenit 451/a të K. Pr. Civile, vendimi gjyqësor i formës së prerë që e ka zgjidhur çështjen në themel, përbën një zgjidhje të natyrës përfundimtare dhe të qëndrueshme të mosmarrëveshjes s'i në kuptimin konstituiv, ashtu dhe atë prekluziv.

Në kuptimin konstituiv, ai jep zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes, pozitive të palëve të kundërta në atë gjykim, ndërsa në kuptimin prekluziv ndalohet mundësia e kërimit në gjykatë të ndryshimeve në zgjidhjen e mosmarrëveshjes së përcaktuar me vendimin gjyqësor të formës së prerë. E thënë ndryshe autoriteti dhe efektet e gjësë së gjykuar janë përfundimtar, procesit civil dhe pamundësia e të njëjtave palë ndërgjyqëse për t'i kërkuar gjykatës që të shqyrtojë dhe të vendosë përsëri mbi të njëjtin objekt gjykimi (*res iudicata est*).

Në kuptimin objektiv, gjëja e gjykuar qëndron në lidhje me të njëjtin objekt të padisë dhe të njëjtin shkak ligjor (*causa petendi*) të saj, ndërsa në kuptimin subjektiv gjëja e gjykuar qëndron në lidhje me faktin që ajo që është vënë në bisedim (kërkimet, pretendimet, prapsimet), sipas parimit të kontradiktorialitetit dhe që është vendosur në gjykim me anë të urdhërimeve të vendimit, është e detyrueshme vetëm ndërmjet palëve ndërgjyqëse në gjykim, trashëgimtarët e tyre dhe personat që tërheqin të drejta nga palët, fakt ky i cili të shpie në përfundimin se arsyeja, mjeti juridik nëpërmjet të cilit ligji mbështet dhe përcakton pakundërshtueshmërinë e asaj që vërtetohet dhe disponohet me vendimin e formës së prerë, është efekti prekluziv, ndalues për ringritjen dhe përsëritjen e parashtrimit në gjykatë të kërtimeve dhe prapsimeve të bëra apo që mund e duhet të ishin bërë rreth mosmarrëveshjes gjatë gjykimit, dhe për të cilat gjykata përfundimisht ka vendosur në zbatim të vullnetit të ligjit.

Fuqia e "gjësë së gjykuar" mbulon jo vetëm pjesën urdhëruese të vendimit të formës së prerë, por edhe rrethanat e çështjes të pranuar në gjykim, përfundimet dhe arsyet në të cilat është mbështetur ai vendim në pjesën arsyetuese dhe që kanë lidhje me atë që urdhëron gjykata në dispozitivin e vendimit të saj.

Nëse në një gjykim të ardhshëm shtrohen për diskutim e shqyrtim çështje të provës apo të së drejtës që kanë lidhje thelbësore me çështjet për të cilat është dhënë një vendim gjyqësor i formës së prerë, pra me çështje që ka çmuar, pranuar dhe urdhëruar gjykata në atë vendim, edhe kur aty ka palë ndërgjyqëse, objekt e shkak ligjor të ndryshëm nga ai i vendimit gjyqësor që ka marrë formë të prerë, apo edhe nëse në dukje mund të parashtrihen s'i kërtime për herë të parë, atëherë ndalohet vënia në bisedim dhe shqyrtimi gjyqësor i këtyre çështjeve, për arsye se në procesin civil, "gjëja e gjykuar" mbulon jo vetëm kërkimet, por edhe prapsimet e parashtruara, apo që mund dhe duhet të ishin parashtruar për të kundërshtuar faktet konstituive të së drejtës së pretenduar në gjykim nga ana e paditësit apo e kundërpaditësit.

Ne rastin konkret, i padituri nuk ka të qartë natyrën e mosmarrëveshjes, objektin dhe shkakun ligjor të saj. Rezulton nga provat e administruara në gjykim se ndërmjet të paditurit Hydro Energji Transformer Topcias-El dhe përmbaruesit gjyqësor e me tej shoqërisë "Mega Wat" sh.p.k. është zhvilluar një gjykim me objekt: "Pavlefshmeri titullit ekzketuiv fatures tatimore me Tvsh Nr. 37, Nr. Serie 86498237, date 01. 08. 2015. Kundërshtimin e veprimeve përmbarimore. Pezullimin e veprimeve përmbarimore për zbatimin e këtij titulli", që është zgjidhur me vendimin Nr. 8791 dt. 04. 11. 2016 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë që ka pranuar padinë pjesërisht dhe që me tej është rrëzuar kjo padi me vendimin Nr. 334 dt. 03. 05. 2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Provohet se në atë proces si palët ndërgjyqëse si shoqëri me vehte, si objekti i padisë dhe shkakun i saj ligjor, nuk kanë asnjë lidhje me këtë proces gjyqësor.

Sa i perket vendimit Nr. 8791 dt. 04. 11. 2016 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, provohet gjithashtu se ky vendim nuk ka lidhje me objektin dhe shkakun ligjor të padisë në shqyrtim. Objekti i padisë në atë vendim ka qenë: "Pavlefshmeri titulli ekzekutiv dhe rrjedhimisht dhe kundërshtim veprimesh përmbartimore për ekzekutimin e këtij titulli., ndërsa gjykimi i sotëm ka për objekt dhe shkak përjashtimin nga shitja me ankand i kuotave të ortakeve të shoqërisë "Hydro Energji Transformer Topcias-El" sh.p.k., aseteve monetare dhe materiale të saj, të cilat nuk janë përfshirë në kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë, duke patur një status të pavarur nga kapitali themeltar i saj.

Sa i perket vendimit Nr. 7520 dt. 15. 09. 2017 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, provohet persëri se ai nuk është një vendim themeli por një vendim jo përfundimtar për shpallje moskompetence.

Pra, sa me siper u arsyetua, çështja objekt shqyrtimi lidhet thjesht dhe vetëm me një shkak konkret ligjor të posaçëm të evidentuar rishtazi dhe që ka buruar nga veprimi përmbartimor konkret i pales së paditur, urdherit Nr. 1782 Prot. dt. 27. 07. 2016 "Për vendosjen e masës së sekuestros". Është pikërisht ky veprim i cili ka përfshirë drejtperdrejt në mënyrë nominale shoqërinë Hydro Energji Transformer Topcias-El sh.p.k. dhe me tej shoqëritë ortek të saj "Dieta" sh.p.k. dhe "Rati" sh.p.k. (paditesit) si subjekte të procedurës përmbartimore (duke i konsideruar debitorë) dhe që si të tilla i legjitimon posaçërisht këtë të fundit në këtë konflikt gjyqësor. Në asnjë nga veprimet e mëparshme përmbartimore objekt konfliktesh gjyqësore të siperpërmendura, shoqëritë "Dieta" sh.p.k. dhe "Rati" sh.p.k. nuk kanë qenë të përfshirë nominalisht si debitorë të këtij titulli ekzekutiv. Vetëm pas veprimit përmbartimor objekt shqyrtimi gjyqësor, e drejta e tyre për të investuar gjykatën është absolute dhe me shkak të posaçëm ligjor.

Nga ana tjetër lidhur me pretendimin e shqyrtuar dhe rrezuar gjatë gjykimit të çështjes dhe të ripërsëritur prej pales së paditur dhe në konkluzionet përfundimtare përse i perket moskompetencës tokësore të kësaj gjykate për shqyrtimin e kësaj çështjeje, gjykata e vlerëson këtë kërkim të pa bazuar në ligj.

Në rastin objekt shqyrtimi kompetenca tokësore përcaktohet nga nenin 612 të K. Pr. Civile (gjykata e vendit të ekzekutimit) dhe që e cila si e tilla konsiderohet Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë pasi që është kjo gjykata që ka lëshuar dhe urdherin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv dhe që në në kuptim të nenve 510/e dhe 511/ç të K. Pr. Civile e ka konsideruar veten e saj si kompetente nga pikepamja e kompetencës tokësore.

Përpos kësaj referuar faktit, në këtë gjykim janë disa të paditur me seli të ndryshme ku krahas të paditurit "Hydro Energji Transformer Topcias-El" sh.p.k. që e ka selinë në Elbasan, dy të paditurit e tjere e kanë selinë në Tiranë. Në këtë kuptim në referim të Neneve 53 dhe 54 të K. Pr. Civile, kur janë shumë të paditur që kanë vendbanime ose vendqendrim të tyre në vende të ndryshme, padia mund të ngrihet në gjykatën e vendit ku ka banimin ose vendqendrimin cilido nga të paditurit dhe e drejta e zgjedhës midis shumë gjykatave kompetente i takon paditesit, i cili e ushtron atë me ngritjen e padisë (siç dhe ka ndodhur).

Se fundmi, referuar Nenit 212/1 të K. Pr. Civile nisur nga vendimmarrja e saj për çështjen, gjykata çmon se vendimi i saj për sigurimin e padisë dt. 23. 06. 2017, duhet të legjitimohet si i tilla.

Nga ana tjetër shpenzimet gjyqësore, taksa e padisë, shpenzimet e përfaqësuesit të pales së paditur që sipas fatures tatimore Nr. 13 dt. 04. 10. 2017, të paraqitur në konkluzionet përfundimtare janë në masën 60.000 leke, janë në ngarkim të pales së paditur.

Për sa me lart u arsyetua, gjykata çmon se kërkesë-padia duhet pranuar teresisht si e tilla, pasi është e bazuar në ligj dhe në prova.

PER KETO ARSYE :



Gjykata bazuar në Nenet 126, 212/I, 306-308, 612 e vijues të K. Pr. Civile.

VENDOSI :

1. Pranimin e kerkese-padise.
2. Perjashtimin nga sekuestrimi dhe shitja ne ankand e kuotave te kapitalit te shoqerise "Hydro Energji Transformer Topcias-El" (W.E.T.T.) sh.p.k., qe zoterohen nga shoqerite "Rati" sh.p.k. dhe "Dieta" sh.p.k.
3. Anullimin e veprimeve te permbaruesit gjyqesor Tomorr Llala per ekzekutimin e Urdherit te Ekzekutimit Nr. 8195 Akti dt. 02. 12. 2015 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane per titullin ekzekutiv, Fature Tatimore Shitjeje Nr. 37 dt. 01. 08. 2015, Nr. 86498237 Serie, vetem persa i perket sekuestros dhe shitjes se kuotave te shoqerise "Hydro Energji Transformer Topcias-El" (W.E.T.T.) sh.p.k. dhe qe zoterohen nga shoqerite "Rati" sh.p.k. dhe "Dieta" sh.p.k.
4. Fshirjen ne Qendren Kombetare te Biznesit te Urdherit Nr. 1782 Prot. dt. 27. 07. 2016 te permbaruesit gjyqesor Tomorr Llala "Per vendosjen e mases se sekuestros konservative mbi titujt e pronesise ne pronesi te debitorit" shoqerise "Hydro Energji Transformer Topcias-El" (W.E.T.T.) sh.p.k.
5. Ligjerimin e mases se sigurimit te marre me vendimin dt. 23. 06. 2017 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.
6. Kunder ketij vendimi lejohet te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 15 diteve, afat ky qe fillon nga e nesermja e shpalljes se tij per palet prezent dhe nga e nesermja e dites se komunikimit te vendimit per palet ne mungese.
7. U shpall sot me date 04. 10. 2017 ne Tirane.

SEKRETARE

LUSJANA FEZOLLARI

GJYQTAR

ERVIN POLLOZHANI

Shpenzimet gjyqësore

Taksë padie	3. 000 lekë
Shpenzime perfaqesimi Av. te Paditurit	60. 000 lekë
<u>Shpenzime njoftimi llog gjykates</u>	<u>1. 600 lekë</u>
Totali	64. 600 lekë

SHENIM: Kundër këtij vendimi është bërë ankim dhe aktet i janë dërguar Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr.265, datë 13.03.2019, ka vendosur :

-Ndryshimin e vendimit Nr.8106, datë 04.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e padisë .

-Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të paditësve.

-Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë.

Tirane, 28.03.2019

ME ORIJINALIN
K / SEKRETARE
VALBONA SADIKU

K/SEKRETARE
Valbona SADIKU



[Handwritten signature]

20.03.2019